i Dërguari i Allahut ﷺ i tha Ebu Bekrit dhe Omerit: "Këta të dy janë zotërinjtë e të moshuarve të banorëve të Xhenetit, nga të parët dhe të fundit, përveç pejgamberëve dhe të dërguarve

Enesi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ i tha Ebu Bekrit dhe Omerit: "Këta të dy janë zotërinjtë e të moshuarve të banorëve të Xhenetit, nga të parët dhe të fundit, përveç pejgamberëve dhe të dërguarve."
[Sahih] [Transmeton Tirmidhiu]

Profeti ﷺ njoftoi se Ebu Bekër Sidiku dhe Omer Faruku (Allahu qoftë i kënaqur me të dytë!) janë më të mirët e njerëzimit pas pejgamberëve dhe më të mirët prej atyre që do të hyjnë në Xhenet pas pejgamberëve dhe të dërguarve.

http://www.sunnah.global/hadeeth/sq/show/11161